



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 7/2018 (JR)
Nr. 7/2 Prot.

Tiranë, më 7.09.2018

SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” njofton palët e procesit, se ditën e martë, datë 25.09.2018, ora 10:00, do të gjykohet në **dhomë këshillimi**, bazuar në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, shqyrtimin e ankimit me nr. çështje 7/2018(JR), datë 9.07.2018, bërë nga subjekti i rivlerësimit z. Fatmir Hoxha kundër vendimit Nr.18, datë 10.05.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykues, përbëhet nga gjyqtarët:

| | |
|----------------------------------|------------------------|
| Kryesues i Trupit Gjykues | Albana Shtylla |
| Relator i Çështjes | Ina Rama |
| Anëtar | Luan Daci |
| Anëtare | Natasha Mulaj |
| Anëtare | Rezarta Schuetz |

Kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para datës së gjykimin, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim.

Ky njoftim bëhet gjithashtu në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe në faqen e internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

KRYESUESI I TRUPIT GJYKUES
GJYQTAR
ALBANA SHTYLLA

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 3, Tiranë, e-mail: info@kpa.al www.kpa.al

